

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi”

Kolegji Universitar “Bedër”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Enkeleda Olldashi



ME. Tildi Çadri



Maj, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Bedër”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Humane/ Departamenti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 286, datë 06.04.2011; UMASH Nr. 534, datë 27.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	UMASH Nr. 223, datë 04.06.2013/ VKA Nr. 469, datë 03.05.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Drejtësi”
6	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Numri i studentëve	89 studentë



HJRJE

Të dhëna për programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi”

(Të dhëna zyrtare për hapjen e programit të studimit, miratimin e hapjes, akreditimin e parë, etj.)

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) është themeluar në vitin 2011 me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër). Ky kolegji universitar funksionon si një organizatë jofitimprurëse. Ky institucion ka marrë lejen për ushtrimin e aktivitetit akademik me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 534, datë 27.10.2011. Akreditimin e parë institucional nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (sot Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – ASCAL) e ka në vitin 2013 me Urdhër nr.223, datë 04.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”. Në procesin e iniciuar dhe realizuar gjatë 2013-2014 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për Verifikimin dhe Kontrollin e Ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, me VKM Nr. 540, datë 06.08.2014 u pezullua përkohësisht veprimtaria e këtij institucioni. Me VKM Nr. 617, datë 18.09.2014, i hiqet pezullimi për ushtrimin e veprimtarisë. Së fundmi, Institucioni ka kaluar procesin e akreditimit periodik institucional dhe aktualisht gëzon statusin “i akredituar institucionalisht”, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 101, datë 10.11.2017. Ky vendim u finalizua pas procesit të riakreditimit institucional të realizuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në kuadrin e bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (QAA).

Struktura akademike paraqitet e qëndrueshme ndër vite për këtë Institucion, pa ndryshime madhore në emërtimin apo përbërjen e njëjësive kryesore dhe atyre bazë. Aktualisht KU “Bedër” përbëhet nga 2 Fakultete dhe 6 Departamente, si më poshtë vijon:

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit;

- Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze
- Departamenti i Shkencave të Edukimit
- Departamenti i Shkencave Kompjuterike

Fakulteti i Shkencave Humane;

- **Departamenti i Drejtësisë**
- Departamenti i Shkencave Islame
- Departamenti i Shkencave të Komunikimit

Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar (**Evidenca nr. 51: Plani Strategjik 2018 – 2023**).

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është licencuar si program studimi i ciklit të parë, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011. Programi është vlerësuar në kuadër të hapjes dhe ka marrë një vlerësim përfundimtar “Pozitiv” sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 159, datë 25.03.2011. Programi i studimit ofrohet me kohë të plotë, me një kohëzgjatje normale prej 3 (tre) vitesh akademike. Programi është akredituar për here të parë me Urdhër Nr. 223, datë 04.06.2013, në përputhje me Vendimin Nr. 469, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit.

Ky program ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane, përkatësisht nga Departamenti i Drejtësisë, njësi bazë në këtë Fakultet.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (më poshtë do të quhet Raporti) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi", ofruar nga Kolëgji Universitar "Bedër". Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. As. Enkelelda Olldashi dhe ME. Tildi Çadri si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj dhe gjatë vizitës nga Znj. Aviola Bardhi.

Kolëgji Universitar "Bedër" është njogur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.05.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 6/58 Prot., datë 17.05.2019. KU "Bedër" përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 147/19 Prot., datë 22.05.2019 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të reflektojnë një ndryshim si më poshtë:

Fq. 30 e Draft-RVJ, ishte: Nga të dhënat e ofruara nga institucioni gjatë vizitës (Evidenca shtesënr.6 "Tabela e studentëve që kanë mbaruar BCH në Drejtësi dhe vazhdojnë MSC) rezulton që studentët që pas përfundimit të ciklit të parë vijojnë cikline dytë të studimeve janë rreth 30%.

Reflektohet paragrafi si më poshtë:


Nga të dhënat e ofruara nga institucioni përmes RVB-së (faqja 81, tabela 17 "Të dhënat për punësimin e studentëve") rezulton që numri i studentëve që pas përfundimit të ciklit të parë vijojnë ciklin e dytë të studimeve është 30 % (nga 100 studentë të regjistruar nga 2013-2019, 30 studentë kanë filluar masterin).

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË


I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimi

- a) Të arrihet niveli i kërkuar për kualifikimin e personelit të brendshëm dhe të jashtëm akademik.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni



- a) Për rekomandimin “**të arrihet niveli i kërkuar për kualifikimin e brendshëm dhe të jashtëm akademik**”, institucioni ka në përbërjen e tij aktualisht 9 antarë të stafit të brendshëm në Departamentin e Drejtësisë, nga të cilët 1 me titull Prof. As, 3 me gradën Dr. dhe 5 me kualifikimin Msc. Grupi i vlerësimit të jashtëm duke vlerësuar dhe konfirmuar informacionin e përcjellë nga institucioni gjykon se **Rekomandimi është përmbushur plotësisht.**



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) i themeluar në vitin 2011 me VKM Nr. 286, datë 06.04.2011, funksionon si një organizatë jofitimprurëse. Departamenti i Drejtësisë është njësi bazë akademike (mësimore-kërkimore) dhe bën pjesë në Fakultetin e Shkencave Humane. Pranë këtij fakulteti janë tre departamente: Departamenti i Drejtësisë; Departamenti i Shkencave të Komunikimit; Departamenti i Shkencave Humane. Departamenti i Drejtësisë ofron programet: “Bachelor” në “Drejtësi” dhe “Master i shkencave” në “Drejtësi” (me profilin; E drejtë Ndërkombëtare/E Drejtë Penale).

Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër”, bazuar dhe në “Planin Strategjik 2018 – 2023” (evidence 51), është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe, mbështetja e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë. Duke u bazuar në “Planin Strategjik 2018 – 2023”, institucioni synon të rrisë dimensionin social të arsimit të lartë, në drejtim të hartimit të politikave arsimore për shtresat sociale të pamundura ekonomikisht, dhe ato të prekshme, duke përfshirë edhe mobilitetin ndërkombëtar për këto shtresa, veçanërisht nxitjen e mobilitetit të studentëve të fushës së edukimit. Departamenti i Drejtësisë si pjesë e këtij institucioni nxit në mënyrë të vazhdueshme rritjen e kapaciteteve akademike në funksion të procesit të mësimdhënies dhe nxënies.

Programi “Bachelor” në “Drejtësi” është i hartuar në përputhje me parimet e procesit të Bolonjës dhe me strategjinë e institucionit. Ky program studimi “Bachelor” në “Drejtësi”, synon përgatitjen e juristëve/profesionistëve të ardhshëm. Programi i studimit “Bachelor”, synon të përgatisë të diplomuar për një treg pune që i përshtatet formimit të tyre, si dhe, mundëson vijimin më tej të studimeve të tyre në një nivel më të lartë akademik. Ky objektivi lidhet me ofrimin nga kjo kurrikul e njohurive në tre degët e së drejtës, si në atë publike, penale dhe private, njohuri të mjaftueshme për përgatitjen e juristëve, si për sektorin publik, ashtu dhe për atë privat. Objektivat e programit të studimit synojnë aftësimin e studentëve në aspektin teorik metodologjik dhe shkencor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	

<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi “Bachelor” në “Drejtësi” në KUB është harmonizuar me misionin e institucionit për përgatitjen e profesionistëve në fushat/disiplinat ku ofrohen programet e studimit. Kombinimi i njohurive ndërmjet këtyre disiplinave ndihmon institucionin të hartojë kurrikula në funksion të përmbushjes së misionit të tij në përgatitjen e profesionistëve të së nesërme me një kulturë në fushat përkatëse. Në funksion të këtij programi studimi ofrohen lëndë/module që mundësojnë përgatitjen e studentëve në një rrafsh sa më të gjerë teorik, social, ekonomik dhe kulturor, duke krijuar për studentët një kulturë të konsoliduar juridike.</p> <p>Programi ofron mundësinë e përthithjes në mënyrë sa më efektive të njohurive bazike në fushën e së drejtës duke i harmonizuar ato dhe me njohuritë nga disiplina të tjera të përafërta me to. Kombinimi i njohurive ndërmjet këtyre disiplinave nxit aftësimin profesional të studentëve.</p> <p>Ky program studimi nxit të menduarin kritik përmes aftësimit në praktik të njohurive të përfuara. Nevoja për përshtatjen e njohurive akademike me ato praktike realizohet përmes lëndëve/moduleve të kurrikulës, të cilat synojnë rritjen e procesit të mësimnxënies.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi “Bachelor” në “Drejtësi” në KUB ofron: grupin e lëndëve të njohurive bazë formuese (28 ECTS); grupin e lëndëve të formimit karakterizues të programit (100 ECTS); grupin e lëndëve në disiplina të ngjashme (15 ECTS); grupin e lëndëve me zgjedhje (20 ECTS); grupin e lëndëve formuese plotësuese (10 ECTS). Kombinimi i këtyre grup lëndësh mundëson realizimin e objektivave të programit për përgatitjen e juristëve në fushën e së drejtës (publike dhe private). Peshën më të madhe në këto grup lëndësh e zënë ato që lidhen me disiplina të karakterizuara të këtij programi, të cilat formojnë studentët në drejtim të njohurive publike dhe private në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi “Bachelor” në “Drejtësi” në KUB është hartuar me synimin e përgatitjes së studentëve për një treg sa më global, duke ofruar njohuri teorike të bazuara në doktrinën bashkohore dhe duke bërë një kombinim të këtyre njohurive me aspektet praktike të kësaj fushe studimi. Strukturat akademike dhe administrative e këtij institucioni synojnë të realizojnë nevojat e studentëve.</p> <p>Institucioni pas hapjes dhe funksionimit të tij në vitin 2011, ka synuar t’i përshtatet detyrimeve ligjore (ligji nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”), duke realizuar dhe një studim të nevojave të tregut në fushën e studimit të këtij programi (evidenca shtojce nr.12 “Studim tregu”). Studimi i tregut është realizuar nga një ekspert i jashtëm, i cili në raportin e observacionit ka renditur ndryshimet dhe përmirësimet në kurrikulën 5-vjecare të programit të integruar. Studimi lidhet me përmbajtjen e kurrikulës dhe</p>

	me grupin e lëndëve në këtë kurrikul, me argumentimin se kjo qasje do të afrooj më shumë dijen e studentëve me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Ky dokument nuk lidhet me indikatorë të matshëm të tregut të punës si: kërkesa për punësim; oferta e punësimit; numri i të diplomuarave në institucionet e tjera të arsimit të lartë, etj.
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	Departamenti i Drejtësisë, në të cilin ofrohet dhe programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi”, nisur nga interesat kombëtare dhe promovimit të vlera më të mira të vendit tonë në fushën e të drejtës, ka përshtatur kurrikulën e këtij programi duke ofruar lëndë/module, të cilat motivojnë dhe nxisin studentët drejt një edukimi, sa global nga njera anë, aq edhe kombëtar nga ana tjetër.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” mundëson përgatitjen e studentëve me njohuri në rrafshin më të gjerë teorik të mundshëm (në fushën sociale, ekonomike dhe kulturore, duke krijuar për studentët një kulturë të konsoliduar juridike). 2. Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është i hartuar në harmoni me njohuritë bazike të fushës së të drejtës publike dhe private si dhe me njohuritë karakterizuese të fushës së të drejtës në mënyrë më specifike . Ky lloj harmonizimi mundëson formimin e juristëve/ profesionistëve të ardhshëm. 3. Kurrikula e programit “Bachelor” në “Drejtësi” është hartuar duke siguruar njohjen dhe nxitjen e ruajtjes së vlerave kulturore, sociale, ekonomike dhe ligjore të vendit tonë. 4. Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” përbëhet nga të gjitha ato grup lëndësh, të cilat janë të domosdoshme për përgatitjen teorike të studentëve drejt një tregu sa më global. 5. Nevoja për përshtatjen e njohurive akademike me ato praktike realizohet përmes lëndëve/moduleve të kurrikulës, të cilat synojnë rritjen e procesit të mësimnxënies. 	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është **Fakulteti i Shkencave Humane**, në përbërjen e së cilës janë 3 (tre) Departamente, respektivisht:

1. **Departamenti i Drejtësisë;**
2. Departamenti i Shkencave të Komunikimit;
3. Departamenti i Shkencave Islame.

Në vijim të vlerësimit paraprak të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe verifikimi nga GVJ gjatë vizitës në vend, Tabelave 1 “Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë” dhe Tableve 2 “ Lista e personelit akademik efektiv dhe me kontratë” rezultojn se aktualisht departamentet, për vitin akademik 2018-19, kanë përbërjen si më poshtë për *vitin akademik 2018-2019*:

1. Departamenti i Drejtësisë

9 PAE, nga të cilët 1 PAE me titull “Prof. Dr”, 3 PAE me gradën “Dr” dhe 5 PAE me Msc.

10 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.Dr”, 3 PAK me gradën “Dr” dhe 6 PAK me Msc.

2. Departamenti i Shkencave të Komunikimit

9 PAE, nga të cilët 4 PAE me gradën “Dr” dhe 5 PAE me Msc.

5 PAK, nga të cilët 1 PAK me titull “Prof.Ass”, 2 me gradën “Dr” dhe 2 Msc

3. Departamenti i Shkencave Islame

11 PAE, nga të cilët 1 PAE me titull “Prof.As”, 4 PAE me gradën “Dr” dhe 6 PAE me Msc.

3 PAK, nga të cilët 1 PAK me gradën “Dr” dhe 2 PAE me Msc.

Nga vlerësimi i treguesve më sipër rezultojn se Fakulteti i Shkencave Humane i përmbush kërkesat ligjore për përbërjen e stafit akademik me titujt dhe gradat shkencore për vitin akademik 2018-2019.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Nga vlerësimi paraprak rezultojn se struktura e Fakultetit të Shkencave Humane nuk ka patur ndryshim dhe është sipas strukturës së miratuar në Statutin e KU “Beder”, sipas **evidencave: Nr. 19 “Organigrama e Institucionit” dhe nr.2 “Statuti i Kolegjit Universitar Beder”**, të miratuara sipas VKM Nr. 286, datë 06.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private BEDER”. Organigrama gjendet bashkëlidhur në Aneks.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit Bsc “Drejtësi” është Departamenti i Drejtësisë. Aktualisht, ky departament ka në përbërje 19 staf akademik, nga të cilët 9 janë PAE dhe 10 PAK. Sikurse është dhënë më sipër, stafi PAE i departamentit është i kompozuar prej 1 “Prof. Dr, 3 “Dr” dhe 5 Msc.

Raportet sipas kualifikimit midis stafit PAE dhe PAK, jepen si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018-19

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 1/ PAK 1; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 0; në nivel Dr. PAE 3/ PAK 3, në nivel Msc PAE 5/ PAK 9.

2. Për vitin akademik 2017-18

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 1/ PAK 1; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 1; në nivel Dr. PAE 3/ PAK 1, në nivel Msc PAE 6/ PAK 9

3. Për vitin akademik 2016-17

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 1/ PAK 3; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 0; në nivel Dr. PAE 3/ PAK 3, në nivel Msc PAE 4/ PAK 10

4. Për vitin akademik 2015-16

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 1/ PAK 5; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 2; në nivel Dr. PAE 4/ PAK 4, në nivel Msc PAE 4/ PAK 12

5. Për vitin akademik 2014-15

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 0/ PAK 5; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 2; në nivel Dr. PAE 5/ PAK 6, në nivel Msc PAE 6/ PAK 12

6. Për vitin akademik 2013-14

- Në Nivel Prof. Dr, PAE 1/ PAK 5; në nivel Prof As, PAE 0/ PAK 3; në nivel Dr. PAE 4/ PAK 3, në nivel Msc PAE 6/ PAK 11

Nga vlerësimi i treguesve si më sipër vihet re një shpërndarje gati e barabartë e kualifikimeve përkatëse, të cilat në të gjitha vitete akademike janë mbi nivelin e sasisë së kërkuar për përbërjen e departamenteve me tituj/grada. GVJ evidenton një nr të lartë stafit akademik PAE të angazhuar në programin e studimit i cili është shumë i lartë në vitete akademike 2014-15 dhe 2015-16, megjithatë ka një renie të ndjeshme ndër vitet akademike me ta afërta, duke kulumuar me rënie në vitin akademik 2018-19 (vetëm 10 PAK). Stafi PAE mbetet i qëndrueshëm në përbërje dhe kualifikim, mesatarisht ëndron në vlerat 9 staf PAE.

Kualifikimi i PAE paraqitet konstant, duke reflektuar një përmirësim nga viti akademik 2013-4 në 2018-19.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik aktualisht është në vlera të kënaqshme përsa i përket numrit të pedagogëve në raport me studentët, të cilët janë të kufizuar në numër (176 në total, të regjistruar dhe transferuar, nga viti akademik 2013-2014).

Institucioni ka ndë marrë masa që të ekulibrohet numri i stafit PAK me atë të PAE, duke ulur ndjeshëm numrin e stafit të jashtëm të angazhuar gjatë viteve në vijim.

GVJ konstaton një nivel të kënaqshëm të shpërndarjes së stafit akademik sipas moshës, ku predominon mosha 25-35 me 6 nga 10 PAE.

Shihet një angazhim i lartë i stafit akademik me Msc si titullarë lëndësh: 15 të angazhuar nga 19 (Sem 1 – sipas të dhënave të Vitit akademik 2018-19). Stafit PAK është i angazhuar nga 5 lëndë si titullar, ndërkaq në 3 prej këtyre lëndëve stafit PAK e ofron lëndën së bashku me një staf PAE, respektivisht lëndët: E drejta Publike; E drejta tregtare; Procedurë Penale.

Nga vlerësimi i evidencës Nr.13 “ Orët e lektorëve”, GVJ konstatoi se numri i orëve total, stafit PAK dhe PAK, rezultoi 1932 për këtë program studimi. **Stafi i brendshëm është përgjegjës për 1470 orë nga 1932, që përben 76% të ngarkesës totale.** GVJ gjithashtu evidenton se ngarkesa e stafit të brendshëm të angazhuar në këtë program në një numër të lartë, i dedikohet vetëm këtij programi studimi. Ky konstatim sjell dedikim me të madh dhe eficient të stafit akademik në këtë program studimi. Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të vetëvlerësimit dhe agjendës së zhvilluar gjatë vizitës në vend, GVJ konstatoi se Institucioni ndjek procedurë publike dhe transparente për procesin e rekrutimit. Institucioni për rekrutimin e stafit të tija akademik, administrativ dhe ndihëms mësimitor- shkencor ndjek dispozitat e Ligjit të Arsimit të lartë Nr. 80/2015; Rregullores së organizimit akademik; Rregulloren e organizimit administrativ.

Në vlerësimin e GVJ, procesi është transparent dhe lidhet drejtpërdrejtë me nevojat e paraqitura për staf akademik që vjen nga njësitë bazë. Kontratat e punës janë të rregullta dhe janë me anekset përkatëse për parashikime e detyrave akademike dhe kërkimore që do të ngarkohen si dhe funksione të tjera administrative (nëse aplikohet).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

➤ Në vitin akademik 2018 – 19, departamenti ka përbërjen si më poshtë:

9 PAE, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 3 me gradën “Dr” dhe 5 Msc.

10 PAK, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 3 me gradën “Dr” dhe 9 Msc.

➤ Në vitin akademik 2017 – 18, departamenti kishte përbërjen si më poshtë:

10 PAE, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 3 me gradën “Dr” dhe 6 Msc.

15 PAK, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 1 me titull “Prof.As” 4 me gradën “Dr” dhe 9 Msc

➤ Në vitin akademik 2016 – 17, departamenti kishit përbërjen si më poshtë:

8 PAE, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 3 me gradën “Dr” dhe 4 Msc.

16 PAK, nga të cilët 3 me titull “Prof.Dr”, 3 me gradën “Dr” dhe 10 Msc.

- **Në vitin akademik 2015 – 16, departamenti kishte përbërjen si më poshtë:**
9 PAE, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 4 me gradën “Dr” dhe 4 Msc.
23 PAK, nga të cilët 5 me titull “Prof.Dr”, 2 me titull “Prof.As” 4 me gradën “Dr” dhe 12 Msc
- **Në vitin akademik 2014 – 15, departamenti kishte përbërjen si më poshtë:**
11 PAE, nga të cilët 5 me gradën “Dr” dhe 6 Msc.
25 PAK, nga të cilët 5 me titull “Prof.Dr”, 2 me titull “Prof.As” 6 me gradën “Dr” dhe 12 Msc
- **Në vitin akademik 2013 – 14, departamenti kishte përbërjen si më poshtë:**
11 PAE, nga të cilët 1 me titull “Prof.Dr”, 4 me gradën “Dr” dhe 6 Msc.
20 PAK, nga të cilët 5 me titull “Prof.Dr”, 1 me titull “Prof.As” 3 me gradën “Dr” dhe 11 Msc

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

GVJ në vlerësimi të dhënave të përcjella dhe atyre të verifikuara konstaton se Institucioni ka një numër stafi PAE përgjithësisht konstant ndër vite. Stafi PAE paraqitet midis vlerave 11 – 8 PAE dhe për vitin akademik 2018-19 rezulton 9.

Në kompozimin e stafit PAE ka gjithmonë 1 Prof. Dr dhe 3 Dr dhe pjesa tjetër rezulton me Msc. Në vlerësim të GVJ ky kompozim është cilësor dhe jep garanci për vazhdimësinë e transmetimit të kualifikimeve në Departamente. Konstatohet se stafi PAK ka një dinamike tjetër të zhvillimit. Gjatë viteve 2013-14; 2014-15 dhe 2015-16 vihet re një nr i lartë i stafit me titull Prof.Dr (5 të tillë) dhe ka një rënie në vitet e tjera ku rezulton vetëm 1 Prof.Dr.

Ndërkaq, stafi PAK me gradën Dr.

Rezulton në nivele të njejta 3-4 përafërsisht në çdo vit akademik. Shihet një ulje e ndjeshme e stafit PAK me Msc, ku ndër vitet 2013-14; 2014-15 dhe 2015-16, rezulton 11-12, dhe rezulton që për vitin akademik 2018-19 është 9 PAK me Msc.

Raportet e stafit akademik PAE dhe PAK jepen si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018 – 19, raporti PAE\PAK është 1 / 2
2. Për vitin akademik 2017 – 18, raporti PAE\PAK është 1 / 1.6
3. Për vitin akademik 2016 – 17, raporti PAE\PAK është 1 / 2
4. Për vitin akademik 2015 – 16, raporti PAE\PAK është 1 / 2.3
5. Për vitin akademik 2014 – 15, raporti PAE\PAK është 1 / 2.3
6. Për vitin akademik 2013 – 14, raporti PAE\PAK është 1/1.8

Të dhënat sipas seksit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Nga përbërja gjinore u konstatua se stafi mësimdhënës me kohë të plotë PAE për vitin akademik 2017-18 përbëhet nga 5 femra dhe 7 meshkuj.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Sipas moshës së personelit të brendshëm viti akademik 2017-18, konstatohet shpërndarja si më poshtë:

Mosha	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Stafi	6	3	1	0	0

Sipas moshës së personelit akademik të kontraktuar konstatohet shpërndarja si më poshtë

Mosha	25-35	36-45	46-55	56-65	66-68
Stafi	3	8	2	2	0

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Institucioni ka një databazë të rregullt të kontratave të punës që administroheshin nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Protokollit. Zyra e Protokollit administronte komunikimet e njësive dhe titullarit për aspektet e rekrutimit ndërsa Zyra e Burimeve njerëzore administronte dosjet përkatëse. (Minutat e takimit në vend – Evidenca 14). Gjatë verifikimit të vend u konstatuan se kontratat ishin të rregullta dhe të firmosur nga Pedagogu/Punëmarrësi dhe Rektori. Kontratrat ishin të rregullta dhe kishin bashkelidhur Aneks për përshkrimin e përgjithshëm të punës dhe detyrave të tjera. Insitucioni kishte ndjekur dhe zbatuar dispozitat ligjore të parashiuar në Statutin e tij, Ligjin e Arismit të Lartë 80/2015, Rregulloren Themelore të Kolegjit Beder.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ i institucionit aktivizohej për të gjitha njësitë e Institucionit, deri në nivel departamenti. Aktualisht stafi i dedikuar administrativ është 1 për cdo departament.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>GVJ konstaton si Institucioni ka parashikime të sakta për rekrutimin e stafit akademik, të sanksionuara në Rregulloren Themelore të KU si dhe në Procedurën e Rekrutimit të Stafit (evidence nr. 14 DVV). Institucioni ndjek procesin e rekrutimit sipas hapave të mirëpërcaktuar dhe diferencon proceset duke i dhene theks më të madh rekrutimit të stafit të brendshëm.</p> <p>Procesi iniciohet nga njësia bazë e cila përpilon dhe kërkesat e punësimit. Përzgjedhja behet sipas nje komisioni <i>ad hoc</i>, ku marrin pjese në të gjitha rastet anatarë të njësisë bazë, e cila e ka propozuar. Komisioni ad hoc përpilonte vlerësimin përfundimtar, e cila i përcillet rektorit për vendimarrje. Nga verifikimi në vend GVJ konstatoi se kontratat e punës ishin të firmosura nga punëmarrësi dhe rektori.</p> <p>Aktualisht, sipas të dhënave për vitin akademik 2017-18 rezulton se stafi akademik I brendshëm mbulon 71% të lëndëve dhe 76% të ngarkesës mësimore.</p> <p>GVJ evidentoi se procesi i vlerësimi të stafit akademik kryhej përmes 3 formave kryesore: Vetvlerësimi i stafit; Vlerësimi nga eprori i drejtëpërdrejtë dhe vlerësimi përmes pyetësorit të studentit. (Evidence 26 dhe 26 e DVV).</p> <p>Aktualisht, Institucioni e administron databazën e personelit të tij përmes zyrës së burimeve njerëzore dhe zyrës së protokollit. Zyra e protokollit administronte korenspondencën e brendshme midisi stafit dhe autoriteteve drejtuese.</p>
---	---

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel</p>	<p>Databaza e të dhënave të stafit akademik administrohej nga Zyra e Burimeve njerëzore, e cila administronte dokumentacionin fizik sipas kerkësave ligjore dhe po ashtu kishte databazën elektronike.</p> <p>Procedurat e rekrutimit të stafit ishin transparente dhe të bazuar në akte nenligjore, gjithashtu informacioni është i pasqyruar në faqen ëeb: www.beder.edu.al. Në faqen ëeb gjendeshin dhe shpalljet për vende të lira dhe mundësia e aplikimit online.</p> <p>Aktualisht Institucioni angazhon një numër të lartë të stafit akademik të brendshëm me kualifikimin Msc si titullarë lëndësh, megjithatë institucioni kishte stimuluar stafin e tij për kualifikimin e metejshem (</p>
--	---

<p>akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,</p>	<p>evidenca nr. 7 gjatë vizitës në vend)</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni dëshmoi përmes RVB si dhe gjatë vizitës në vend, një angazhim të përshtatshëm të të gjitha resurseve të tij për zhvillimin e programit të studimit. Evidentohet nga GVJ se ka një qasje praktike në metodologjinë e mësimdhënies përmes stimulimit, si psh gjyqe të inskenuara, praktika gjyësore nga gjyqtarë të ftuar, etj.</p> <p>Në institucion funksiononte dhe Zyra e planifikimit të karrierës e cila ndiqte nga pranë ecurinë e studentëve dhe ndërthurte angazhimin e stafit në departamentet përkatëse me studentet e këtij programi studimi.</p> <p>Institucioni nuk ka të parashikuar lëndën “Praktikë Profesionale”, megjithatë ashtu sikur u dëshmuar gjatë takimit në vend, Institucioni angazhohej për mundësimin e praktikave të studentëve, (evidenca nr. 31 DVV). GVJ rekomandon formalizimin e kësaj praktike të deritanishme për tu siguruar studentëve praktikën profesionale.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni ka mundësuar një sërë trajnimesh të lidhura më së shumti me kualifikimin e stafit të brendshëm akademik. (Evidenca nr. 32 DVV) Trajnimit konsistojnë në metodologjinë e mësimdhënies, vlerësimin e studentëve dhe trajnime për përdorimin e teknologjive të reja të implemetuara. Trajnimet organizoheshin më së shumti nga lektorë të ftuar, vendas dhe ndërkombëtar.</p> <p>Databaza e dokumentacionit fizik dhe elektronik ishte e përditësuar dhe e aksesueshme.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Staf i akademik I brendshëm mbulon 71% të lëndëve dhe 76% të ngarkesës mësimore 2. Institucioni kujdeset për ofrimin e trajnimeve në fusha të ndryshme të stafit të tij akademik. 3. Institucioni dëshmon një sistem shumë eficient të administrimit të të dhënave, në format elektronik dhe fizik, e cila fasilton komunikimin dhe përcjelljen e informacionit në kohë reale. 4. GVJ rekomandon formalizimin e praktikës së ndjekur nga institucioni për ofrimin e mundësive për praktikë profesionale të deritanishme, për t’u siguruar studentëve mundësi të aplikimit në njohurive në institucione publike dhe private. 	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

Kolegji Universitar “Beder” ushtron aktivitetin e tij në adresën Rr. “Jordan Misja”, pallatet “Usluga”. KUB zotëron një kontratë qeraje për një periudhë 10 vjeçare ,për dy godina, me sipërfaqe totale 5628 m2.

Në godinën A, zhvillohej mësimi për programet e ofruara nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë, me sip 3957 m2. Ambientet janë në sasi të konsiderueshme dhe plotësohen kërkesat teknike për normativën e sipërfaqes. Sallat e mësimdhënies janë të paisjura me konditioner dhe video projektore/ tabela inteligjente. Aktualisht sipërfaqja për studentn rezulton 8.1m2/student. Institucioni kishtë në dispozicion Bibliotekën qendrore e cila qëndronte e hapur nga ora 08:30 deri më 19:00.

KUB zotërontë 1 lojratrë informatike, ambiente shplohëse për studentët dhe menza e cila ishte e hapru për stafin akademik dhe perosnelin e KUB.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

(Tabelat në Aneks)

Mjediset për stafin

(Tabelat në Aneks)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Institucioni ka siguruar për studentët e tij Bibliotekën e Institucionit, e cila përditësohej vazhdimisht sipas kërkesave të pedagogëve çdo fillimi viti akademik. Biblioteka kishte kopjet fizike të literaturës së detyrur sipas Syllabusesve përkatëse. Aktualisht biblioteka kishte një fond prej 36 000 tituj librash, të cilat ishin siguruar gjithashtu përmes projeteve studentore dhe dhurimeve (Ambasada Amerikan – Tetor 2018). KUB është abonuar dhe në bibliotekën online Ebsco Host, ku studentët mund të aksesonin libra dhe revista shkencore në gjuhën angleze, rreth 45 000 tituj. Biblioteka gjithashtu ishte e organizuar sipas një databaze online, e cila lehtësonte kërkimin e titujve dhe organizohej në bazë të Udhëzimit të Bibliotekës (
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë	

<p>një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Evidenca nr.13 DVV).</p> <p>Orari i Bibliotekës ishte 08:30 deri më 19:00, dhe gjithashtu gjatë sezonit të provimeve qëndronte e hapur dhe në fundjave.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>KUB, në funksion të programit të studimit ka vënë në dispozicion të studentëve ambiente të përshtatshme sikurse janë evedentuar nga GVJ edhe gjatë vizitës në vend.</p> <p>Aktualisht, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të paisjura me mjete didaktike si smart board apo/dhe videoprojektore.</p> <p>Institucioni ka venë në dispozicion një sallë laboratorit informatike të lidhur në rrjet si dhe WiFi në të gjithë godinën.</p> <p>Gjithashtu GVJ evedentoi dhe Laboratorin e Gjuhëve të huaja, Qendrën e Medias, sallën e gjyqit, të cilat i shërbenin dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p>KUB dëshmoi kapacitete të larta për zhvillimin e praktikave profesionale, të dëshmuara dhe gjatë vizitës në vend, sidomos në zyrën e burimeve njerëzore dhe zyrën e kërkimit shkencor.</p>
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Instituconi zotëron një bibliotekë të pasur në numër dhe tituj librash si dhe ka mundësuar aksesimin e bibliotekës elektronike për studentët e tij. 2. Infrastruktura në dispozicion është e mjaftueshme dhe krijon mundësi për zhvillimin e plotë të programit mësimor duke ofruar dhe mundësi për krijimin e një ambienti rekreacioni për të gjithë studentët. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar "Bedër" është institucion privat jofitimprurës. Si e tillë, pjesa më e madhe e të ardhurave gjenerohen nga donacionet si dhe pagesat e studentëve. Institucioni auditohet periodikisht dhe siguron shërndarjen e burimeve financiare sipas programit të miratuar, në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim - N/A
- Konsulencat, shërbimet - 2 %
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit - 96%
- Sponsorizimet - N/A
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) - N/A
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj - 2%
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) - N/A

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

GVj konstoi se rreth 98% e shpenzimeve shkojnë për për shpenzimet dhe kostot e punës. Më shumë të dhëna gjenden në Tabelën 7 të RVB.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Institucioni duke zotëruar statusin e institucioni jofitimprurës, sigurohet për shëndetin e tij financiar përmes auditimit të vazhdueshëm dhe raportimit.
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	KUB paraqet çdo fundviti raportin vjetor institucional, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	KUB ndjek zbatimin e legjislacioni për statutin përkatës, vecanërisht Ligjin e arsimit të lartë 80/2015; Ligjin 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" si dhe bazën ligjore për kontabilizimin dhe pasqyrat financiare.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>KUB çdo vit përgatit një raport financiar nga një kontabilist i miratuar dhe e depoziton atë sipas akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Institucioni sipas vlerësimit të GVJ, dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe rezultton me një menaxhim të mirë të aseteve të tij në funksion të programit të studimit.</p> <p>Nga vlerësimi i evidencave në funksion të këtij standarti dhe numrit të studentëve evidentohet një shëndet i plotë financiar dhe ecuri të qëndrueshme.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni sigurohet të auditohet në mënyrë periodike dhe të raportojë në institucionet përgjegjëse për situatën e tij financiare. 2. Duke qënë se KUB ka statusin e organizatës jofitimprurëse, resurset e tij financiare sigurohen të rialokohen në shërbim të institucionit dhe studentëve. 3. Institucioni përmes evidencave të paraqitura dëshmon të ketë qëndrueshmëri dhe shëndet të plotë financiar. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

KUB ka institucionalizuar Sistemin e tij të Brendshëm të Cilësisë, i cili është sanksionuar në Statutin e KUB si dhe rregulloreve përkatëse (evidenca Nr. 8 DVV). NjSBC, siaps nenit 28 të Statutit të KUB, është struktura përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë. Ajo varet drejtpërdrejtë nga Rektori dhe përbëhet nga 5 (pesë) antarë, nga të cilët 1 ekspert i jashtëm.. Gjithashtu njësia çdo vit raporton për aktivitetin e saj te Senati Akademik. Aktualisht, sigurimi i brendshëm i cilësisë, sigurohet përmes dy strukturave: Komisioni i përhershëm i granatimit të cilësisë dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë.



Sipas informacionit të paraqitur në RVB dhe Rregullorës së Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, misioni i kësaj të fundit është vlerësimi periodik i efikasitetit të veprimtarive mësimore, kërkimore-zhvillimore, si edhe të veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit.

NJSBC mbilidhet minimalisht 8 herë në vit dhe kujdeset për të mbështetur Komisionin e përhershëm të cilësisë, në hartimin e standarteve të cilësisë së brendshme.

Ajo organizon pyetësin e studentit, për cilësinë e lëndëve të çdo programi studentor, kryen studime gjurmuese për ecurinë e punësimit të studentëve të saj, vlerëson rezultatet e veprimtarive mësimore-kërkimore si dhe propozon modele nga praktikat më të mira vendase dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, në funksion të sigurimit të cilësisë KUB është pajisur dhe me Certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, e cila siguron standartizimin e proceseve dhe dokumentacionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

1. Realizohen 2 anketime me studentët në vit. Deri me tani rezultojnë 12 anketime në total përgjatë të gjithë viteve.
2. Procesi i vetëvlerësimit ngritur nga rektori përmes një komisioni *ad hoc* për administrimin e dokumentacionit nga njësitë administrative dhe akademike (evidenca nr. 36 DVV)
3. Organizime të trajnimeve sipas kërkesave të Stafit akademik dhe stafit administrativ – 24 në total (Evidenca nr 32. DVV)

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ushtron veprimtarinë e saj sipas dispozitave të Statutit të KU “BEDER”, Rregullores së KU “BEDER” dhe “Rregullores së NJSBC”. NJSBC rezulton ti raportojë Rektorit në mënyrë të drejtpërdrejtë për rezultatet e anketimeve si dhe u jep pedagogëve përkatës rezultatet në mënyrë konfidenciale. Njësia ka përdorur dhe instrumenta të tjera për kontrollin e cilësisë si p.sh: studime gjurmuese për të diplomuarit; procese të vetëvlerësimit të stafit akademik, si dhe ka identifikuar disa nevoja për trajnim të stafit akademik. Njësia gjithashtu koordinon dhe bashkëpunon me institucionet e sigurimit të jashtëm të cilësisë në kuadër të proceseve të akreditimit të programeve të studimeve dhe ato institucionale. Ajo rakordon dhe koordinon punën me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për shkëmbimin e të dhënave dhe raportimeve dhe ndjek nga pranë proceset e vlerësimit të jashtëm dhe hartimit të Rapoerteve të Vlerësimit të Cilësisë.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Monitorimi dhe menaxhimi i proceseve të sigurimit të cilësisë në Institucion, realizohen në nivel Fakulteti dhe koordinohen nga NJSBC.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet janë vjetore dhe kryhen nga NJSBC. Ato shërbejnë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të marrë masat e nevojshme të përmirësimit të saj. GVJ u njoh me rezultatet e vetëvlerësimeve për vitin akademik 2017-2018

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Njsbc, ashtu sikundër u diskutua gjatë takimit në vend, i raporton Rektorit mbi rezultate e anketimit dhe në mënyrë konfidenciale ja përcjell të dhënat çdo pedaogu (përmes portalit që administron llogarinë e çdo pedagogu). Gjithashtu ajo furnizon me të dhëna dhe këshillim Komisioni e përheshëm të cilësisë, i cili është përgjigjës për përcaktimin e standardeve të brendshme të cilësisë në Institucion (Neni 10; Rregullorja e Njsbc, evidenca nr. 8 DVV)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p>	<p>Institucioni dëshmoi se ka një eksperincë të gjatë në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke përdorur disa instrumenta vlerësuese dhe duke ndërthur disa njësi për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Aktualisht, në KUB funksionin Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave që merret me hartimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve, bazuar dhe në rezultatet e anketimeve dhe në ekspertizën e jashtme.</p> <p>Institucioni përmes sistemit të tij të administrimit elektronik BIS u mundëson publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të vlerësimit të gjithë palëve të interesuar. Gjithashtu, Institucioni përmes Komisionit të tij të përhershëm të cilësisë, ka siguruar hartimin dhe ndjekjen e Strategjisë Institucionale ku evidentohet dhe parashikimet për sigurimin e përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i njësisë konsistentë në : Vlerësimin e studentëve: Vetëvlerësimi i stafit përkundrejt standarteve të brendshme dhe Vlerësimi nga</p>

<ul style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj. 	<p>eproi i drejtpërdrejtë.</p> <p>Anketat sipas vlerësimit të GVJ, janë të plota dhe përmbajnë pyetje dhe çështje të ndryshme që lidhen me aspektet përmbajtësore të lëndës; qasjen e pedagogut; infrastrukturës etj.</p> <p>GVJ evidentoi se Institucioni aplikonte disa metoda të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës b. Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës. c. Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga KUB d. Pyetje konceptuale e. Rekomandime nga studentët
	<p>Metoda të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; b) Vlerësime me notë dhe me pikë; c) Vlerësim të detyrave dhe të projekteve të kryera nga studentët; d) Vlerësimi i studentëve më të mirë duke ju ofruar çertifikata nderi; e) Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një</p>	<p>KUB është i akredituar institucionalisht në vitin 2017 nga APAAL në bashkëpunim me QAA – UK.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka marr masa për ngritjen e kulturës së cilësisë në Institucion dhe ka implementuar Planin Strategjik 2018-2023 (evidenca nr. 51 DVV).</p> <p>Institucioni përmes Komisionit të përhershëm të garatimit të cilësisë ka implemtuar standartete e brendshme të cilësisë të cilat përmirësohen vit vitit.</p> <p>Procesi i përmirësimit të programit të studimit iniciohet nga departamentet përktës dhe miratohet në senat. Procesi motirohet dhe koordinohet nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave.</p>
---	--



<p>strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Plani strategjik është i miratura në senat dhe është i publikuar në faqen web: https://www.beder.edu.al/sh/news/other/plani-i-ri-strategjik-i-institucionit/1117</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni ka venë në zbatim shumëllojshërmi formatesh të vlerësimit të brendshëm të cilësisë: Vetvlerësimi; pyetëtori i studentëve dhe i stafit akademik; vlerësimi i eprorëve të drejtëpërdrejtë etj, të cilat sigurojnë për cross- checking të informacionit dhe vlerësimit. 2. Institucioni disponon një sistem shumë të përshtatshëm për administrimin e proceseve të vlerësimit të brendshëm, BIS, të cilën GVJ e konsideron si praktikë të mirë. 3. Institucioni kujdeset që të ketë politika të përditësuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë përmes hartimit dhe zbatimit të Planeve Strategjike. 4. Krijimi i strukturave të përshtatshme, të cilat krijojnë llogaridhënie dhe raportim, në vileve të ndryshme si : Komisioni i Përhershëm i sigurimit të cilësisë dhe Njësia e sigurimit të cilësisë janë garanci për krijimin e kulturës së cilësisë në Institucion. 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE


7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” synon përgatitjen e juristëve profesionist në fushën e të drejtës publike dhe private. Objektivat e këtij programi studimi lidhen me aspektet përmbajtësor të kurrikulës, e cila synon aftësimin e studentëve në aspektin teorik metodologjik dhe shkencor. Në mënyrë më specifike këto objektiva janë të materializuara në drejtim të: njohjes së aspektit ligjor, social, ekonomik, historik, politik dhe filozofik të sistemit të drejtësisë në Shqipëri; integritit teorik dhe praktik të informacionit juridik; zhvillimeve dhe ndryshimeve midis sistemeve të së drejtës; etikës profesionale; përvetësimit të dijeve nga disiplinat e tjera. Përmbajtja e lëndëve/moduleve të kurrikulës së këtij proram studimi “Bachelor” është e harmonizuar dhe i përgjigjet qëllimit të objektivave të programit. Lëndët/module janë të ndara në kredite sipas sistemit ECTS me orë të përcaktuara në auditor dhe jashtëauditorit.

Në “Rregulloren e studimeve të ciklit të parë dhe provimeve” (neni 13) parashikohet që në kurrikulën e ciklit të parë të studimeve mund të ketë edhe lëndët me parakushte (lëndë të lidhura me njëra-tjetrën). Në



këtë program studimi “Bachelor” në Drejtësi nuk rezulton asnjë lëndë që të ketë një lëndë si parakusht për tu ndjekur.

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” përbëhet nga 35 lëndë pa përfshirë temën e diplomës (12 lëndë viti i parë; 12 lëndë viti i dytë; 11 lëndë viti i tretë). Pragu i notës mesatare, që i jep të drejtë studentit të ciklit të parë të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome është nota shkronjë C me koeficient 2.00, sipas nenit 15 dhe 16 të “Rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve”.

Në programin “Bachelor” në Drejtësi, praktika profesionale nuk është pjesë e programit mësimor, por departamenti merr masa që t’ua mundësojë studentëve zhvillimin e tyre. Gjatë takimit me studentët në institucion, GVJ morri opinionin e studentëve në lidhje me rëndësinë e këtij komponenti në formimin e tyre. Studentëve iu mundësohej ndjekja e praktikës pranë ndonjë institucioni publik apo privat edhe pse ky angazhim i tyre nuk ishte pjesë e kurrikulës së programit. Numri në përqindje i studentëve që kanë zhvilluar praktikë individuale është nga 30 – 40 % .Vendet ku studentët kanë kryer praktikë individuale sipas dokumentit të vënë në dispozicion të GVJ gjatë visitës në institucion (Evidenca shtesë nr. 11)janë : bashkitë, prefekturat, Ministria e Drejtësisë, gjykata, studio ligjore

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Bedër”ka filluar në vitin 2011.

Objektivat e programit të studimit “Bachelor” në “Drejtësi” janë:

- njohja e sistemit të drejtësisë në Shqipëri (aspektet ligjor, social, ekonomik, historik, politik dhe filozofik);
- zhvillimeve dhe ndryshimeve midis sistemeve të së drejtës;
- përvetësimi i dijeve dhe nga disiplinat e tjera, të lidhura ngushtësisht me fushën e së drejtës.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Bedër” është i oraganizuar në tre vite akademike (6 semestra). Viti akademik përbëhet nga semestri i vjeshtës dhe i pranverës. Sezone të veçanta mund të zhvillohen me miratim të Senatit Akademik. Kohëzgjatja normale e secilit semestër është 16 javë. Në raste të nevojshme, kohëzgjatja e tyre mund të shtyhet nga Senati Akademik. Viti akademik organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratore në javë.

Fillimi i vitit akademik dhe kalendari i provimeve përcaktohet çdo vit nga Senati dhe publikohet.

- 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS është 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore është 50 min

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 1728 orë në auditor dhe 2321 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 256 orë në auditor dhe 120 orë punë e pavarur e studentit

- Për Labororet 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 32 orë në auditor dhe 143 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Në programin i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” në Kolegjin Universitar “Bedër” nuk ka ndryshime nga programi i studimit i licensuar. Nga takimet që GVJ realizoi me drejtuesit dhe aktorët e tjerë përgjegjës për realizimin e një procesi, konstatoi që nuk ishte e parë e nevojshme rishikimi i kurrikulës në nivelin e ndryshimeve në të. Ky fakt u argumentua dhe me faktin që ky program studimi, në kuadrin e ndryshimeve ligjore pritet të riorganizohet dhe strukturat përkatëse kishin hartuar për këtë dokumentacionin e nevojshëm (të dhëna në lidhje me këtë fakt gjenden në raport në faqen 14 dhe janë shoqëruar dhe me disa nga dokumentat e nevojshëm sic është “Studimi i tregut të punës” Evidenca shtesë nr.12).

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Në lidhje me formimin akademik (titujt/gradat shkencore) dhe eksperiencën akademike të stafit akademik, GVJ konstaton që:

a) në shumicën e lëndëve të këtij programi studimi, stafi akademik ka eksperiencën e duhur akademike dhe përvojën e duhur praktike, që është e nevojshme në disa prej lëndëve të kësaj kurrikule. Ky konstatim i mësipërm lidhet me lëndë të tilla si: E Drejta Administrative; E drejta e Detyrimeve; E drejta Familjare; E drejta Penale; E Drejta Civile; Historia e Shtetit Shqiptarë dhe së Drejtës në Shqipëri...etj).

b) Në disa prej lëndëve të kësaj kurrikule stafi akademik në statusin e lektorit nuk ka një përvojë të pasur akademik edhe pse është e mirëkuptueshme që pjesë e stafit akademik duhet të jenë edhe pedagogët pa përvojë, të cilët duhet të mbështeten nga stafi me përvojë. Ndërmjet anëtarëve të stafit akademik GVJ konstatoi një frymë bashkëpunimi akademik.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën

- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset për çdo lëndë janë të paraqitura si evidenca nga institucioni. Çdo syllabus përmban elementet e kërkuara sipas standarteve dhe modelit të VKM-së përkatëse: Emërtimin e lëndës; vitin akademik dhe semestrin përkatës; emrin dhe titullin apo gradën shkencore të pedagogut/ëve; ngarkesën akademike në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; objektin e studimit të lëndës; aftësitë që studentit i mundësohen nga kjo lëndë; temat të cilat do të zhvillohen e shqëruar me literaturën përkatëse për çdo temë; lënda në formimin teorik dhe praktik; format dhe metodat e mësimdhënies; format e vlerësimit të studentëve; detyrimet e studentit; literatura e detyruar dhe atë ndihmëse.

Përmbajtja e tyre pasurohet çdo vit akademik nga titullari i lëndës duke u nisur nga ndryshimet që fusha të vaktuara të jurisprudencës ndodhin (kjo u konstatua nga GVJ gjatë takimit me stafin akademik në institucion).

Në lidhje me vlerësimin që nga syllabus-et GVJ realizoi, u konstatua që format e vlerësimit të dijeve të studentëve në të gjithë lëndët e kësaj kurrikule përbëheshin nga: provimi gjysmë finale, i cili zë në varësi të lëndëve nga 20%- 30%; kuize, të cilat zënë nga 0- 5 % (d.m.th., ky component ishte në pak lëndë); projekte, të cilat zënë nga 20 %- 30%; pjesëmarrja në mësim nga 5% - 10-%. Në total, kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final nuk është më shumë se 50 %, ndërsa kontributi i provimit final mbi vlerësimin final varion në këtë rast nga 30% - 70 %.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Të gjitha plan-programet e lëndëve/moduleve janë të organizuara në sistemin e krediteve ECTS, të ndarë me orë pune në pune në auditor dhe në orë punë e pavarur e studentit. Përmbajtja dhe objektivat lëndëve/moduleve janë të qarta dhe të harmonizuara me literaturën përkatëse. Komponentët e vlerësimit i përgjigjen qëllimit dhe objektivave të lëndëve. Sistem i ivlerësimit është me sistemin e notave, pikeve dhe gërmave. Pedagogët kanë formimin e duhur akademik.

Të gjitha syllabuset janë në formën elektronike dhe studentët njihen me ato përmes sistemit BIS.

Nga analiza e syllabureve dhe nga materiali i vënë në dispozicionit të GVJ (evidencat për çdo syllabus), në lidhje me literaturën bazë dhe ndihmëse për programin e studimit “Bachelor” në “Drejtesi” në KU “Beder”, mund të arrijmë në përfundim që:

- literatura për çdo lëndë/modul është parashikuar në syllabusin përkatës në varësi të tematikave që parashikohen të trajtohen përgjatë semestri nga ana e pedagogut përkatës.
- Literatura përditësohet për çdo vit akademik, në varësi të ndryshimeve ligjore
- Studentët e aksesojnë lehtësisht literaturën e përshkruar në syllabuset e cdo lëndë/moduli

Analizë e ndarjes së lëndëve sipas kategorive formuese:

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të formimit të përgjithshëm (A): ofrohen 6 lëndë me 28 ECTS në total, duke zënë rreth 16% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndë në këtë kurrikul është brenda standarteve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të formimit kategorizues të këtij programi të studimi (B): janë 19 lëndë me 100 ECTS, duke zënë rreth 56% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standarteve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disiplina të ngjashme apo integruese të këtij programi studimi (C): janë 3 lëndë me 15 ECTS, duke zënë rreth 8% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standarteve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disipline zëgjdhje të këtij programi studimi (D): janë 17 lëndë prej të cilave zgjidhen vetëm 5 lëndë me 20 ECTS, duke zënë rreth 11% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standarteve.

Në grupin e lëndëve të kategorizuara si disipline plotësuese të këtij programi studimi (E): janë 2 lëndë me 10 ECTS, duke zënë rreth 6% të totalit të krediteve. Pesha e këtyre lëndëve në këtë kurrikul është brenda standarteve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca shtesë nr. "listën e praktikave të ndjekura nga studentët nëpërmjet zyrës së planifikimit të karrierës".

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" në Drejtësi, i ofruar për herë të parë në vitin 2011, është akredituar në vitin 2013.</p> <p>Programi i studimit "Bachelor" në "Drejtësi" zhvillohet në tre vite akademike (me 180 ECTS) dhe në cdo vit akademik janë 60 ECTS (të ndara në 30 ECTS për çdo semestër).</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin</p>	<p>Programi i studimit "Bachelor" në Drejtësi është pjesë e Departamentit të Drejtësi, i cili është një ndër tre njësitë bazë të fakultetit të Shkencave Humane. Departamenti i Drejtësisë si njësi mësimore kërkimore shkencore ka në përbërjen e tij stafin akademik dhe administrative të nevojshëm për të mundësuar dhënien e shërbimit të duhur akademik për studnetët, në lidhje me të gjithë komponentët e procesit mësimor. Kjo njësi ofron shërbimet e duhura akademike dhe gjerë</p>

informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

akoma për t'iu siguruar studentëve të gjithë informacionin e duhur akademik. Sistemi informatik BIS i krijuar pranë këtij institucioni mundëson një informacion të plotë për përmbajtjen e kurrikulës dhe të gjithë komponentëve përbërës të saj. Studentët asistohen përgjatë këtij procesi nga këshilltari akademik, një anëtar i stafit të departamentit, i cili monitoron procesin e marrjes dhe të kuptuarit të informacionit të nevojshëm për studentët.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është një program i akredituar në vitin 2013.
2. Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi”, stafi akademik dhe administrative, mundëson dhënie të shërbimit të duhur akademik për studentët, në lidhje me të gjithë komponentët e procesit mësimor. Struktura dhe mekanizmat akademik që aplikon Departamentit i Drejtësi (si një ndër tre njësitë bazë të fakultetit të Shkencave Humane) janë në funksion të procesit të informimit të studentëve dhe të mbarëvajtjes së procesit mësimdhënie dhe mësimnxënie.
3. Plan-programet e lëndëve janë të organizuara sipas sistemit të krediteve ECTS; përmbajtja dhe objektivat e lëndëve janë të qarta dhe të harmonizuara me literaturën përkatëse dhe, komponentët e vlerësimit i përgjigjen plotësisht qëllimit dhe objektivave të lëndëve.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në bazë të “Rregullores Themelore” (neni 78) dhe “Rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve” (neni 10), procesi mësimor për programet e studimit të ciklit të parë parashikohet në total me jo më shumë se 22 provime dhe mbrojtje e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë. Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” janë gjithsej 35 lëndë, pa përfshirë mbrojtje diplome.

Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi”, regjistrimet semestrale të lëndëve që do të frekuentojë studenti bëhen në mënyrë elektronike, sipas “Udhëzuesit të Sistemit Informativ Bedër” (evidenca nr.14). Studenti miratohet në sistem nga ana e departamentit. Studentët kanë adresën e

tyre të e-mailit me emrin e përdoruesit dhe fjalë-kalimin e saj. Në faqen e internetit të departamenteve dhe programeve akademike në URL: http://bit.ly/beder_programs. Studentët nëpërmjet këtij sistemi informohen në lidhje me lenden, nivelin e lëndës, tipin i saj, parakushtet, oret e leksioneve, klasat e seminareve, klasat e laboratoreve, kreditet, ECTS, gjuha e lendes, përshkrimin e lëndës, objektivat, materialet, rezultatet e vlerësimit, metodat e vlerësimit, pjesmarrjen në mësim, orët përkatëse dhe përqindja që ndikon në vlerësimin final.

Vlerësimi sasior i punës së studentëve në Kolegjin Universitar “Bedër” kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij european ECTS, të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 16 të “Rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve”.

Në bazë të nenit 87 të “Rregullores Themelore”, studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome, në varësi të pragut të notës mesatare. Në rregulloren e përgjithshme të programeve të studimit “Bachelor” në Drejtësi (neni 15) është përcaktuar si prag i notës mesatare, nota shkronjë C me koeficient 2.00, që i jep të drejtë studentit të diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Në KUB është i miratuar formati I fletës së provimit (Evidenca nr. 50: Format provimi)

Në bazë të nenit 102 të “Rregullores Themelore”, ankimi ndaj rezultatit në provim Në rast se studentit ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Grupi i vlerësimit të jashtëm, nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, evidentoi një rast ankimimi në lidhje me vlerësimin e lëndës dhe konstatoi që parashikimi në rregulloren e sipërcituar ishte respektuar.

Për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin “Bachelor” në Drejtësi janë organizuar dhe trajnime për stafin akademik me temë “Why and How to Evaluate Teaching” (Evidenca shtesë nr.4). Për rritjen e procesit të mësimnxënies janë organizuar trajnime me temë “Improving student engagement” (Evidenca shtesë nr.5).

Bazuar në “Planin Strategjik 2018 – 2023” (Evidenca nr. 51), synohet: të shkohet drejt një qasjeje, e cila si në procesin e mësimdhënies, ashtu edhe atë të vlerësimit, t’i aftësojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për t’i përgatitur për sfidat e ardhshme; të kalohet në një metodologji vlerësimi, e cila bazohet plotësisht në ndërtimin e aftësive të menduarit kritik, në vend të mënyrave tradicionale të vlerësimit; Të kalohet nga metodologjia e vlerësimit tradicional në ese dhe prezantime.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione 1656
- Seminare 256
- Ushtrime 0
- Laboratore 0
- Detyre 0
- Praktikë lëndore 0
- Praktikë profesionale 0
- Provime 72

Në total 1984

Format e kontrollit të njohurive

- Gjysmë finale 20%- 30%
- Kuize 0- 5 %
- Projekte 20 %- 30%
- Pjesëmarrja në mësim 5% - 10-%
- Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final 50 %
- Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final 30% - 70 %

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të njësisë në lidhje me punimet shkencore individuale të pedagogëve (në 40 punime); në projektet shkenore të organizuara nga njësia (në 70 projekte); në projektet shkenore në nivel fakulteti (në 40 të tilla) dhe në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerët (në 35 të tilla).

Pranë KU “Bedër” është dhe “Qendra e Kërkuesve të Rinj”, e cila është krijuar për të mbështetur studentët që dëshirojnë të zgjerojnë njohuritë e tyre në shkencat humane du ke bërë kërkime në funksion të formimit të tyre (Evidenca nr.18)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca shtese nr. 4 “Why and How to Evaluate Teaching”

Evidenca shtese nr.5” Improving student engagement”

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në bazë të nenit 58 të “Rregullores Themelore” të Kolegjit Universitar “Beder”, kriteret për regjistrim lidhen me përmbushjen e tyre dhe dorëzimin e dokumentacionit: a) vërtetimin me dokument zyrtar të mbarimit të shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit (të ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin), duke paraqitur diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave; b) plotësimin e kriterit të notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit

të Ministrave; c) plotësimin e kritereve përzgjedhëse, kur ato janë si parakusht për përzgjedhjen e kandidatëve. Për shtetasit e huaj kërkohet edhe dokumentet e mëposhtme: a) Paraqitja e lejes së qëndrimit në momentin e regjistrimit (kopje e noterizuar); b) Dokument që vërteton njohjen e gjuhës shqipe fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës ose dokument që vërteton njohjen e gjuhës së programit. Në bazë të nenit 5 të “Rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve”: kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%. Intervista realizohet nga komisioni i vlerësimit. Ky komision ngrihet nga ana e Departamentit të Drejtësisë.

Në Kolegjin Universitar “Bedër”, bazuar dhe në nenin 60 të “Rregullores Themelore”, pranohen dhe studentët me aftësi të kufizuar, të cilëve iu garantohen të gjitha facilitetet infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse, të projektuara në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuar për studentët në fjalë. Pranë këtij programi studimi ka student me aftësi të kufizuar dhe gjatë takimit që GVJ realizoi me studentët u njoh dhe me një student me aftësi të kufizuara, i cili nuk kishte asnjë vështirësi infrastrukturore apo akademike për të ndjekur normalisht procesin mësimor.

Pranë këtij institucioni është krijuar dhe funksionon në mënyrë mjaft efektive dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Studentët, e cila mundëson realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare.

Pranë Kolegjit Universitar “Bedër” janë ngritur dhe “Klubet studentore” dhe një ndër ato është dhe “Klubi studentor i drejtësisë” i quajtur “Klubi studentor Bedër Laë Academy” i krijuar me Vendimin e datës 18.12.2017. Ky Klub mundëson veprimtari ekstrakurrikulare shkencore në nivel studentor, social-kulturore dhe sportive, për studentët e programit “Bachelor” në Drejtësi.

Departamenti i Drejtësisë ka marrë pjesë cdo vit akademik në organizimet e konkurseve të studentëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të tilla si “gjqet simuluese”.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” kriteri i notës mesatare është në masën 70% dhe kriteri i intervistës është në masën 30%. Intervista mund të realizohet edhe online (informacion që GVJ-së iu dha nga studentët gjatë vizitës në institucion). Gjatë takimit me studentët një ndër studentët në takim deklaroi që ai vet kishte zhvilluar fazën e intervistës online.

Në bazë të “Planit Strategjik 2018 – 2023” (evidence 51), punësimi i studentëve të diplomuar do të vijojë të mbetet një nga matësit universalë të cilësisë dhe të vlerës që ka institucioni. Në këtë kontekst, institucioni synon të nxisë punësimin e të diplomuarve të vet për të promovuar të diplomuarit dhe vet institucionin

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” gjatë viteve 2013-2019, nota mesatare në hyrje e studentëve varion nga 7.6 në 8.2. Gjatë këtyre viteve janë regjistruar 172 studentë dhe 4 kanë qenë të transferuar d.m.th., në total janë 176 studentët. Nga të dhënat e ofruara nga institucioni përmes RVB-së (faqja 81, tabela 17 “Të dhënat për punësimin e studentëve”) rezulton që numri i studentëve që pas përfundimit të ciklit të parë vijnë në ciklin e dytë të studimeve është 30% (nga 100 studentë të regjistruar nga 2013-2019, 30 studentë kanë filluar masterin).

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

GVJ e vlerëson notën mesatare të studentëve në hyrje, në raport me kërkesat e ligjit, të lartë dhe e vlerëson si fakt mjaft pozitiv për institucionin.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka të dhëna për këtë tregues.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Bazuar në aktet juridike të brendshme (Statuti dhe Rregullorja), KU "Beder" ka krijuar një strukturë akademike për shqyrtimin e dokumentacionit përkatës; marrjen e vendimit të pranimit apo jo për të vijuar studimet pranë këtij institucioni; ekuivalentimin e lëndëve përkatëse sipas krediteve të fituara nga institucioni përcjellës në raport me ato që në programin konkret të studimit janë. Komisioni i krijuar (Komisioni i Ekuivalentimit), merr vendimet rast pas rasti duke përcaktuar vitin akademik në të cilin studenti i pranuar do të vijojë studimet, si dhe, përcakton numrin e krediteve të njohura dhe ato që duhet të marrë në vijim të programit përkatës të studimit. Brenda sistemit të arsimit në vend në vitin 2013-2014 është transferuar një student; për vitin 2014-2015 një student; për vitin 2015-2016 asnjë student; për vitin 2016-2017 asnjë student; për vitin 2017-2018 dy studentë; për vitin 2018-2019 asnjë studentë.

*Sipas të dhënave që gjenden në RVB (fq. 81), institucioni krijon mundësi mobiliteti për studentët e tij që ata të ndjekin studimet dhe në një nga universitetet me të cilat kanë një partneritet në lidhje me mobilitetin. Për sa raportohet në RVB, studentët që kanë përfunduar këtë program studimi kanë realizuar një mobilitet akademik për një semestër apo për periudhë më afatgjatë në disa universite të BE: University LUISS Guido Carli, Itali ; Universidad Complutense Madrid, Spain; University of London, Mbretëri e Bashkuar; Universiteti Katolik i Lionit, Francë; The University of the East of Scotland, Mbretëri e Bashkuar; Universiteti Saints Cyril and Methodius, Maqedoni; School of American Laë-Greqi; Universiteti Bolonjes, Itali; International Model United Nations, Kosovë; Universiteti Luksemburgut, Luksemburg; The University of Viadrina Summer School "The European System of Human Rights Protection"; Kyata Einter University for Security Studies; Inter-University Center in Dubrovnik kurs në "Crime Prevention through Criminal Laë and Security Studies" .etj. Në RVB nuk gjenden të dhëna mbi numrin e studentëve në këto universitete. Gjithsesi, GVJ nga takimi që realizoi me studentët në institucion u inform prej tyre në lidhje me mundësinë e mobilitetit që institucioni ofron.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Numri total i studentëve të diplomuarve në programin e studimit "Bachelor" në "Drejtësi" është 100, ndërsa i të punësuarve në përputhje me diplomën është 36 d.m.th., rreth 36% e tyre arrijnë të përshtasin njohuritë e tyre me vendin e punësimit. Numri total të diplomuarve që vijojnë studimet në nivelin e dytë (nivelin master) është 30 d.m.th., 30% e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë kanë jo vetëm rezultatet e duhura, por duan të thellojnë edhe më shumë njohuritë e tyre.

Numri total të diplomuarve

Numri total i studentëve të diplomuarve në programin e studimit "Bachelor" në "Drejtësi" është 100.

Nga ky numër total i të diplomuarve (ndër vitet 2014-2018), kanë vijuar studimet në ciklin e dytë numri i studentëve si më poshtë (sipas evidencës shtesë nr.6):

Për vitin akademik 2014- 15 studentë;

Për vitin akademik 2015- 8 studentë;

Për vitin akademik 2016- 10 studentë;

Për vitin akademik 2017- 16 studentë;

Për vitin akademik 2018- 10 studentë;

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të diplomuarve në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është 36.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të diplomuarve në programin e studimit “Bachelor” në “Drejtësi” është 26.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca shtesë nr.8 “Klubi studentor i drejtësisë”

Evidenca shtesë nr.6 “tabela e studentëve që kanë mbaruar BCH në Drejtësi dhe vazhdojnë MSC

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimit në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në programin “Bachelor” në “Drejtësi” kriteret e pranimit lidhen me ato të notës mesatare në masën 70% dhe kriterin e intervistës në masën 30%. Intervista realizohet nga komisioni i vlerësimit i ngritur në nivel departamenti. Në këtë program studimi ofrohen dhe bursa për studnetët më mesatare mbi 9 (nëntë).</p> <p>Bazuar në “Plani Strategjik 2018 – 2023”, KUB synon rishikimin dhe përditësimin e procesit të pranimit të studentëve, në mënyrë që të sigurohet tërheqja e studentëve më të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; Të ruhet politika aktuale që synon cilësinë dhe jo sasinë, duke përcaktuar numrin e studentëve, në përputhje me cilësinë dhe aftësinë e kandidatëve dhe mundësitë reale për të ofruar një arsimim të nivelit të lartë; (Evidenca nr. 51)</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p>	<p>Në bazë të nenit 63 të “Rregullores Themeltare” dhe nenit 6 të “Rregullores së studimeve të ciklit të parë dhe provimeve”, Departamenti i Drejtësisë ka zgjedhur një pedagog si këshilltar akademik, e cila ndjek dhe udhëzon çdo student mbi procesin</p>

<p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>akademike (përmbajtjen e kurrikulës; syllabuseve të lëndëve; detyrimeve akademike. etj), gjatë gjithë periudhës së studimeve. Ky këshilltar akademik miraton formularët e regjistrimit semestral për çdo student dhe më pas studentit regjistron elektronikisht lëndët që do të marri në semestrin përkatës.</p> <p>Në bazë të “Rregullores së Anketave dhe Vlerësimeve”, parashikohet marrja e informacionit nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, administrativ dhe studentët. Ky informacion analizohet në funksion të vlerësimit të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi të ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”. Anketimi dhe vlerësimi përfshin dhe: Anketën e vlerësimit të studentit ndaj institucionit; Anketën vlerësuese të studentit për stafin akademik. Anketa e vlerësimit studentor për stafin akademik/lëndën ka për qëllim marrjen e informacionit në lidhje me mësimdhënien e stafit akademik ndaj studentëve dhe kjo anketë përbëhet nga 15 pyetje dhe për çdo pyetje ka 5 mundësi zgjedhjeje. Të dhënat nga ky anketim i bëhen të njohura autoriteteve. Ky anketim zhvillohet 2 herë në çdo vit akademik. Nga takimi që GVJ pati me studentët, ata u shprehën që ankesat apo shqetësimet e tyre të adresuara përmes këtyre anketimeve kishin qënë të volitshme.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p>	<p>Për programin e studimit “Bachelor” në Drejtësi, institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar; të transferuar; ata që ndërpresin studimet dhe, ata të diplomuar ndër vite. Ecuria akademike e studentëve ndiqet në mënyrë periodike nga ana e departamentit dhe organeve të tjera që disponojnë këto të dhëna. Për sa u përket çështjeve të transferimit të</p>

<p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>studentëve, çështjeve që lidhen me arsimin dhe provimet, si dhe ato që kanë të bëjnë me shkëputjen e marrëdhënieve me departamentin, vendimmarrja i takon Këshillit të Departamentit.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Këshilltari akademik në nivel departamenti, ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari akademik ndihmon studentin dhe në rastin e zgjedhjes nga ana e tij, apo edhe nga ana e institucionit të vendit ku student deshiron të ndjekë një praktikë mësimore edhe pse kjo nuk është pjesë e kurrikulës së këtij programi studimi.</p> <p>Një nga njësitë me karakter administrative pranë KUB është: Drejtoria e marrëdhënieve me studentët që përfshin Zyrën e Planifikimit të karrierës, Zyrën e Shërbimit Psiko-social dhe Shëndetësor, Zyrën e koordinimi të klubeve studentore dhe Zyrën e të diplomuarve. Këto njësi administrative janë funksionale dhe mjaft efikase.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Plani Strategjik institucional 2018 – 2023”, synon përmirësimin e proceseve të pranimit në drejtim të nxitjes së pranimeve për studentët më të mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar 2. Institucioni (KUB) ka një strukturë administrative funksionale dhe në shërbim të studentëve. Njësitë me karakter administrative pranë KUB mundësojnë realizimin e një planifikimi të mirë të karrierës së studentit (zyra e Planifikimit të karrierës). Njësitë administrative ofrojnë dhe shërbime të tjera për studentët si: shërbime Psiko-social dhe Shëndetësor; shërbime ekstrakurrikulare (zyra e koordinimi të klubeve studentore). 3. Institucioni (KUB) ka të ngritur në nivel departamenti strukturën e këshillimit akademik, funksion që realizohet përmes këshilltarit akademik të caktuar nga Departamenti i Drejtësisë, i cila ndjek dhe udhëzon cdo student në vijimësi mbi të gjithë komponentët e procesin akademik. 	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësi, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në bazë të nenit 5 të “Rregullores Themelore”, një ndër organet e tjera drejtuese të Kolegjit Universitar është dhe Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin. Funkcionimi i Komisionit të përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin parashikohet në nenin 15 të “Rregullores Themelore”. Ky komision është organi përgjegjës që nxit kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Komisioni organizon veprimtaritë kërkimore mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara nga njësitë bazë dhe kryesore. Komisioni vlerëson performancën e punës kërkimore shkencore në të gjitha nivelet, mbështetur në standardet e miratuara nga Senati Akademik në përputhje me standardet kombëtare. Veprimtaria vjetore e komisionit të përhershme për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin miratohet në Senatin Akademik të Kolegjit Universitar “Bedër”.

Në bazë të “Planit Strategjik 2018 – 2023” (evidence 51), institucion synon të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionit, si një forcë shtytëse për zhvillimin ekonomik dhe social por dhe për të ruajtur një bazë të gjerë dijesh për shoqërinë, duke e shndëruar këtë dhe në një nga qëllimet e institucionit. Institucioni do të vijojë të përkrahë përgatitjen e studentëve për jetën e tyre profesionale, qytetarinë aktive dhe zhvillimin e tyre personal.

Nga përmbajtja e dokumentit shtesë që GVJ iu vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion_“Plan veprimi dhe objektivat e kërkimit shkencor” dalin qartë objektivat që institucioni ka parashikuar për vitin akademik 2018-2019, në lidhje me vlerësimin dhe monitorimin e veprimtarisë kërkimore shkencore. Ky vlerësim dhe monitorim do të konsistojë në lidhje me: vlerësimin e projekteve kërkimore shkencore; konferencave kërkimore-shkencore; revistave shkencore të institucionit; veprimtarisë kërkimore-shkencore të stafit akademik; veprimtarisë kërkimore të studentëve; vlerësimit të infrastrukturës lidhur me kërkimin shkencor. Në lidhje me mbështetjen e stafit akademik në veprimtari shkencore si pjesëmarrje në konferenca, është hartuar një dokument (evidenca shtesë nr.2), e cila iu vu në dispozicion GVJ, gjatë vizitës në institucion. Nga ky dokument rezulton që Kolegji Universitar “Bedër” (sipas udhëzimit me numër BU-DIR-004-AL) mbështet pjesëmarrjen në konferenca me elementet: tarifë pjesëmarrje; akomodim; transport. Kjo mbështetje bëhet me kushtin që publikimet të bëhen në emër të institucionit. Nga kjo mbështetje përfitojnë tarifë pjesëmarrje edhe lektorët që marrin pjesë me video konferencë. Departamenti i Drejtësisë organizon në mënyrë periodike konferenca ndërkombëtare të studiuesve të rinj “Statuti i qendrës së kërkuesve të rinj”

- Lista e trajnimeve të organizuara për stafin gjatë viteve 2014 (sipas evidencës nr. 32)

Për vitin akademik 2014 – dy trajnime

Për vitin akademik 2015 – dy trajnime

Për vitin akademik 2016 – tetë trajnime

Për vitin akademik 2017 – pesë trajnime

Për vitin akademik 2018 – gjashtë trajnime

Numri i studentëve të aktivizuar në aktivitete të njësisë : për punime shkencore individuale të pedagogëve është 40; për projekte shkencore në rang Departamenti është 70; për projekte shkencore në rang Fakulteti është 40; për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë është 35.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Stafi Akademik (sipas të dhënave që gjenden në RVB nga faqa 112-117) ka realizuar shumë publikime në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dhënat në mënyrë narrative për vitet 2013 – Dhjetor 2018, si më poshtë:

1. B. S ka realizuar botime shkencore ne revistën shkencore “Beder Journal of Humanities” si dhe 7 konferenca shkenocre Ndërkombëtare
2. N.B ka realizuar botime shkencore ne revista shkencore tre artikuj dhe 13 konferenca shkencore.
3. F. Xh ka realizuar botime shkencore ne revista shkencore
4. I. F ka realizuar botime shkencore ne revista shkencore gjatë artikuj dhe tre konferenca shkencore.
5. B. H ka realizuar botime shkencore ne revista shkencore katër artikuj dhe katër konferenca shkencore.
6. F. Gj realizuar botime shkencore ne revista shkencore dy artikuj dhe tre konferenca shkencore.
7. G. S ka realizuar botime shkencore ne revista shkencore dy artikuj dhe një konferenca.

Aktivitete shkencore individuale dhe në këtë program studimi “Bachelor” në Drejtësi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar (në vitet e fundit) është si më poshtë:

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare është katër pjesëmarrje; numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore) është 20; numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit është katër; Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime është 15 dhe numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor është shtatë.

Nisur nga të dhënat e RVB-së dhe nga verifikimet e GVJ, në lidhje me të dhënat e përmbledhura të veprimtarisë shkenocre të stafit akademik për tre vitet e fundit rezualton që numri i botimeve nga personeli akademik është 60; numri i projekteve kërkimore të fituara është katër; numri i projekteve të zbatuara është tre; numri i aktiviteteve shkenocre të organizuara për këtë program studimi është 20; numri i pjesëmarrjes në aktivitete shkencore Brenda innstitutionit është 160.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Evidenca shtesë nr.10 “Plan veprimi dhe objektivat e kërkimit shkencor”

Evidenca shtesë nr.2 ‘procedura e mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca”

Evidenca nr.18 “Statuti i qendrës së kërkuesve të rinj”

11. **Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

KUB dëshmon se ka një vemendje të shtuar drejt ndërkombëtarëzimit. Akulisht, GVj konstatkon një nukmër të lartë bashkëpunimësh me institucione vendase dhe ndërkombëtare, që shtrihen në disa aspektë: shkëmbim stafi dhe studentësh; praktika të studentëve; projektë të përbashkët dhe konferenca e ëorkshope.

Më konkretisht GVJ evidentoi se KUB në funksion të programit të studimit ka marrëveshje me me Universitetin e Barit, “Aldo Moro”, Universitetin e Kalabrisë, Universitetin Tor Vergata, Romë, Universitetin e Ljubljanes, Universitetin METU, Ankara, Universitetin e Venezias, Universitetin e Amsterdam, Universitetin Eëns Consin Oshkosh dhe Universitetin e Bolonjës etj.

Gjithashtu, bashkëpunimet janë mbështur dhe për të mundësuar trajanimet e ndyrshme të stafit akademik. (evidenca Nr. 32 DVV).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

GVJ duket shqyrtur dhe analizuar marrëdhëniet e bashkëpunimit që KUB ka vendosur, me institucione brenda dhe jashtë vendit, konstaton se KUB ka një fokus të shtuar për ndërkombëtarizimin e programeve të tij dhe krijimin e kushtëve për ndërtimin e partneritet duke përfutuar nga eksperienca e Universiteteve të tjera, sidomos jashtë vendit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

(Tabelat në Aneks)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ evidentoi nje fryme të mirë bashkëpunimi në institucion. KUB dëshmoi se ipmlementuar sprocese të standartizuar të cilat mundësonin shkëmbinim e informacionit dhe llogaridhënies brënda institucionit. Kjo mundësohej përmes sistemi BIS (Beder information System) i cili menaxhote komunikimin jo vetem të stafit akademik por edhe të studentëve.</p> <p>GVJ evidentoi se KUB kryente analiza të shpeshta në nivel departamenti; fakulteti dhe institucioni.</p> <p>Institucioni ka krijuar një klimë bashkëpunuese dhe rakorduese midis strukturave të tij akademike dhe administrative duke nxitur ndërveprimin midis tyre në funksion të transparencës dhe rritjes së cilësisë</p>

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtjshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

GVJ konston një numër të lartë të bashkëpunimeve, me objekt të ndryshëm, rreth 60 marrëveshje me Institucione të arsimit të lartë vendase dhe ndërkombëtare si dhe Institucioni publike e private brenda vendit.

Gjithashtu institucioni ka dëshmuar një iniciative në mundësimin e trajnimeve të ndryshme (24 në total).

Gjithashtu, Departamenti i Drejtësisë për realizimin e objektivave të programit ka pasur bashkëpunim dhe mbështetje me Ambasadën Norvegjeze që u mundësoi studentëve pjesëmarrjen në konkursi i simulimit gjyqësor të së Drejtës Ndërkombëtare Filip C. Jessup, duke tërhequr pjesëmarrës nga mbi 680 Universitete në më shumë se 100 vende në vitet e fundit.

Institucioni marrëveshjet e bashkëpunimit i ka vendosur aplikuar përmes shkëmbimit të stfit akademi, studentëve dhe aktiveteve të përbashkëta akademike, si workshope, konferenca etj. Aktualisht nuk është vendosur marrëdhënie kontraktuale për përftimin apo dhenie e shërbimit ndaj paleve të treta.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka vendosur shumë marrëdhënie bashkëpunimi, sidomos me institucione të huaja akademike e cila do të mundësojë shkëmbimin e mëtjshëm të eksperiencave akademike dhe studentore.
2. GVJ vlerëson se institucioni ka marrë iniciativa të duhura për mundësimin e trajnimeve dhe zhvillimin e mëtjshëm të stafit akademik.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Për rekomandimin “të arrihet niveli i kërkuar për kualifikimin e brendshëm dhe të jashtëm akademik”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duke vlerësuar dhe konfirmuar informacionin e përcjellë nga institucioni gjykon se **Rekomandimi është përmbushur plotësisht.**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Institucioni ndjek progresin e studentit përmes krijimit të strukturës së duhur të monitorimit akademik (siç është këshilltari akademik që ndjek dhe udhëzon çdo student në procesin akademik).
2. Institucioni përmes njësive administrative ofron shërbime sociale; psiko-social; shërbime ekstrakurrikulare (sic është organizimi i aktiviteteve përmes klubeve studentore).
3. Institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme për personat me aftësi të kufizuara.
4. Institucioni ka ndërtuar “Sistemin Informativ Bedër”, përmes të cilit realizohet i gjithë procesi akademik dhe administrative, duke filluar nga procesi i regjistrimit të studentëve në klasa; provime; marrje rezultateve të vlerësimit; komunikimi me pedagogët në lidhje me literaturën.etj.

b. Pika të dobëta:

1. GVJ-ja konstaton mangësi në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB-së). Këto mangësi lidhen me mungesën e të dhënave standarde dhe në disa raste me informacione jo relevante.
2. Mungesa e praktikës profesionale, si pjese e kurikulës së këtij programi, kërkesë e artikuluar dhe nga vetë studentët.

c. Mundësitë:

1. Institucioni ka stafin e duhur akademik dhe administrative për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm brenda kërkesave dhe paramestrave të duhur ligjor.
2. Aktivizimi i plotë i marrëveshjeve të bashkëpunimit, sidomos me institucionet ndërkombëtare do të mundësonte ndërkombëtarizimin me të plotë të programit. Kjo do të mundësonte dhe afrimin e me shumë studentëve të huaj në institucion.

d. Pengesat:



1. Institucioni duhet të shohë mundësinë e përfundimit të kampusit universitar, duke qënë se zhvillimi i mësimit në godinë, e cila nuk zotërohet nga Institucioni, krijon pengesa në investime dhe përmirësime.

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon realizimin e “Studimit të tregut”, duke u mbështetur në indikator sasiorë dhe cilësorë të matjes dhe jo vetëm në analiza të përmbajtjes së programve të lëndëve apo kurrikulës në tërësi. Kjo qasje nda këtij lloj dokumenti do të mundësonte për institucionin një prespektivë më objektive për atë që përmes këtij dokumenti kërkohet të arrihet.
2. GVJ rekomandon që Institucioni të vlerësojë mundësinë për përfshirjen e Praktikës Profesionale si lëndë në planin mësimor.

Strengths points:

1. The institution follows the student's progress through the creation of a proper academic monitoring structure (as is the academic advisor who follows and guides each student in the academic process).
2. Institution through administrative units provides social services; Psycho-social; extracurricular services (such as organization of activities through student clubs).
3. The institution guarantees the necessary infrastructure for people with disabilities.
4. The institution has an internal Information System, through which the entire academic and administrative process is realized, starting from the process of student enrollment in classes; test; evaluation results; communication with lecturers about literature and the other academic issues.

Weaknesses points:

1. The GVJ notes some shortcomings in the drafting of the Internal Evaluation Report (RVB). These shortcomings are related to lack of standard data and in some cases with irrelevant information.
2. Lack of professional practice, as part of the curriculum, which was expressed as a request by the students themselves.

Opportunities:

1. The institution has the appropriate academic and administrative staff to draft the internal evaluation report, within proper legal requirements and due diligence.




Threats:

1. The Institution should evaluate the possibility to to finalise the establishment of the univeristy campus, since the facility where the teaching activity take place is not the property of the HEI, provides difficulties in investment and improvement.

Recommendations:

1. The GVJ recommends the realization of "Study of Labour Market" based on quantitative and qualitative indicators, and not just analysis of curriculum as a whole. This approach to this type of document would provide the institution with an objective perspective on what this document should be.
2. It is recommended that the Institution evaluate the possibility for students to have the course of "professional practice" as part of the curriculum.

Grupi i Vlerësimit të JashtëmProf. As. Enkeleda Olldashi ME. Tildi Çadri 